



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË XII TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 21.12.2016 (E Mërkurë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje munguan Arbëresha Ibrahimimi dhe Baki Nebiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e XII të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara, dëshiroj te ju falënderoj te gjithëve për përmbylljen e një viti jashtëzakonisht te suksesshëm. Ju e dine që me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale jemi te obliguar ti mbajmë 10 seanca, ndërsa ne sot po e mbyllim me seancën e 12. Ju falënderoj te gjithëve për kontributin që keni dhënë në miratimin e vendimeve dhe rregulloreve, të cilat kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për qytetaret e Komunës se Vitisë. Pasi që është seanca e fundit për këtë viti, dëshiroj t'i falënderoj te gjitha organizatat te ndryshme të cilët me një formë e kane ndimur Kuvendin Komunal ne mbajtjen e takimeve, që kane qenë shume te rëndësishme si punëtori te ndryshme, e falënderoj DEMOS-in, OSBE-në e te gjitha te tjerët që e kanë ndihmu

Kuvendin. Pasi që jemi në fund vit, me lejoni të ju uroj të gjithëve festat e fund viti e posaçërisht komunitetit Katolik krishtlindjet. Dua te ju informoj, që në seancën e kaluar kemi be se bashku grupet parlamentare një deklaratë te përbashkët rreth kyqjes ne autostradë. Para dy dite kemi pas një takim që ka qenë kryetari dhe shefat e grupeve parlamentare kane qenë te gjithë te ftuar, por disa nuk erdhën, ku jemi taku me ministrin, për kyqjen ne autostradë, ku nga ai takim është dal një konkludim, që ministri se bashku me kryeministrin do ta shikojnë mundësinë e rikyqjes edhe njëherë në autostradë. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë se Administrimit të Pushtetit Lokale, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, përpos njërit dhe atë kem të bëjmë me faljen e borxheve nga taksa komunale për bizneset. Meqë e kemi marr para dy dite, nuk kemi mujt me përgatit për këtë seancë propozim vendimin, po un po ju informoj, besoj që ne seancën e janarit do të shikojmë këtë nëse është ne kundërshtim me ligjin do ta anulojmë këtë vendim te tillë.

Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

znj.Mirlinda Sadiku: Përsëndetje për te gjithë të pranishmit! Më vjen keq qe nuk munda te ju bashkëngjitëm ne takimin me ministrin, për kyqjen në autostradë, por, për shkaqe objektive nuk kame mujte te ju bashkëngjitëm. Pyetje që i kamë për Drejtorinë e Inspeksionit dhe Drejtorinë për Bujqësi, se a keni vërtetu gjendjen se çfarë është bë, si erdhi deri të prerja e pishave ne fshatin Terpezë, a është dënu ai operator, a është ndërmarr ndonjë procedurë çoftë ajo gjyqësore, me intereson po ashtu për Drejtorinë e Bujqësisë ta di, se sipas Agjencionit të Pyjeve të Kosovës, planifikohen të pyllëzohen dikun rreth 3000 hektar, dhe shuma e ndarjes është 450 mije euro, a planifikohet që ajo pjesë që është dëmtu ne fshatin Terpezë te ripyllëzohet e pse jo edhe pjesë tjera, kur e dimë që pyjet e Vitisë kogjo shumë janë të dëmtuar. Kamë pyetje edhe nga fshataret e fshatit Shusht, ata duhen ta din se a janë në hartën e Vitisë për investime kapitale. Ai lokalitet ani pse është i vogël, nuk ka tretuar, nuk ka ndreqim publik, aty janë 32 fëmijë që shkojnë ne këmbë tek shkolla ne Binçë dhe shpeshherë janë target i sulmeve të qenve endacak, prandaj kërkoj një përgjigje. Te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, kur kini filluar mandatin keni pas përmend që keni një investim me komisionin evropian për renovimin e shtëpisë se kulturës, me intereson ta di çka ndodhi me at investim, a mos është sikur palestra sportive që po premtohet që disa vite e nuk po shohim që po realizohet. Kam kërkesë nga fshataret e fshatit Skifteraj, që rruga “17 Shkurti” dhe “Rruga e UÇK” te hynë ne investime kapitale që do te bëhen ne vitin 2017. Kjo është gjendja që është evidente nga vete fshataret, nuk është ne gjendje te mirë ne këtë udhë kalon autobusi, i cili barte nxënësit, e ku ka rrezik edhe prej shirave, ujërave atmosferik. Kishte me qenë mirë te merret parasysh, se e dimë që me buxhet janë nda diku 320 mije euro për shtruarjen me asfalt të rrugëve rurale, te kihet parasysh kërkesa e këtyre fshatrave.

z.Bekim Azizi: Faleminderit Kryesues, përsëndetje për të gjithë të pranishmit! Është seanca e dyte a po e tret që jemi tu e mbajt pa kamera, po mendoj që nuk është në rregulle kjo, se për informim bajagi shume kanë shku do mjete, që është dashtë kjo pune te kryhet me herët. Sot

kisha ngrit një çështje, duke e par që një raport i avokatit e popullit për Drejtorinë e Arsimit në funde të muajit 11, ku paraqet shkelje të rënda të pranimit të kuadrit nëpër shkolla, është një shqetësim, sepse avokati i popullit paraqet, që Komuna e Vitisë ka bërë shkelje, respektivisht Drejtoria e Arsimit ka bërë shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut në trajtim jo të barabartë të kandidatëve gjatë intervistimit. Raporti thotë, që komisioni nuk ka qenë sipas udhëzimeve administrative i bërë edhe konkurset nuk janë shpall në harmoni me ligjet, d.m.th tri vërejtje serioze i ka Drejtoria e Arsimit. Besoj që drejtori ka me na dhënë përgjigje për këtë. Një pyetje tjetër, qetu rreth rrugës së Pozharanit është vendos një gyp, që do të mbledh do kanalizime dhe derdhet në lume atje në bllatat e Pozharanit, nuk e di, drejtori i Inspeksionit është këtu, duhet me ditë që nuk lejohet asnjë gyp i asnjë kanalizimit të derdhet nëpër lumenj, ju prej kahit jeni tu e marr jeni tu e qu atje, ka shqetësime nga njerëzit shumë, d.m.th kjo nuk është në rregull, është jo sipas ligjit. Te punëtorët me shërbime të veçanta që i keni, jam konsultu me disa punëtor, i kalon kontrata nuk e diçka bëni, ata punojnë, i leni me punu, paga nuk kane marr që një kohë, ishe një numër begi i mirë i punëtorëve që punojnë e nuk marrin paga, kemi rastin me shkollën e Smirën, e kemi sekretarin që pesë a gjashtë muaj nuk merr paga, ati i thuhet rri aty, e punëtorët në Komunë që i keni marr me kontrata në vepër, ata rrinë qatë e do nuk marrin pagë se ju ka kalu koha, ndërsa ju prapë i mbani qatë përderisa rrinë e kryen punë e nuk merr paga, nuk e di çka jeni tu bërë, qekjo nuk është e mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Sa i përket përcjelljes së seancave nga ana e shtëpive televizive na ka skadu kontrata dhe akoma nuk kemi arrit me bërë, por, nuk jemi tu bërë shkelje, sepse edhe sugjerimet që i kemi pas nëpër takime sigurish nga viti i ardhshëm ata do ta bëjnë monitorimi në formën qyshe ka qenë me herët, d.m.th. e bënë ingjizimin do të ju dërgohet ministrisë.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për ju të pranishëm! Kam një pyetje, dhe shumë herë kemi pas pengës nga kamerat që kane qenë në sallë gjatë seancave, du me dite arsyen pse mungoj këto, dhe kam një kërkesë nga auto taksit. E dimë që me herët është bërë gjvendosja prej pjesës aty ku ka qenë pasqyra kanë dal mbrapa gjykatës, është shumë mirë që kanë dal, është liru vendi aty, ajo hapësira për qarkullim, mirëpo edhe kjo pjesa knej po ka shumë pengesa, sepse po bllokohet me parkingje në anën e kundërt, është mirë me vendos një shej bile se paku prej asaj pjese që është be ajo hapësira për taksit në anën e kundërt që mos me lan me pargu automjete se po ka problem edhe për qarkullim për qytetaret.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Së pari po filloj me fshatin Drobesh, kur e patëm bërë planin e mobilitetit për Komunën e Vitisë patëm thënë se do ta bëjmë një zgjerim të asfaltit të udhëkryqi, ku nxënësit vazhdimisht rrezikohen për me dal me shku të shkolla, e patëm bërë edhe patëm than se do të behet ajo, po pyes aty kur do të behet. Pyetje tjetër edhe për digën, çka u bërë me at central atje mbi Binçë, ku kane mërr punët, sa kane punu, a janë tu vazhdu punët, një sqarim. Për bisedën që kemi qenë te ministri, biseda ishte shumë e mirë, shumë e afërt, e përzemërt, shoqërore, por, përshtypje që e kam fitu aty është se nuk jemi na bolle bindes, që për me binde ministrin se për çka vyen rruga, autostrada për Viti. Në këtë aspekt

kisha pas dëshirë që ne ta bëjmë një ekip që do ta bënë një elaborat, se për çka ti nevojitet Vitisë autostrada dhe me i cek arsyet, edhe kështu, që kur te shkojmë te kryeministri të jemi me të përgatitur ekipi jonë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka te tjerë, u parashtruan disa pyetje, po ja jap fjalën drejtorëve dhe mandej nënkryetari.

znj. Kaltrina Sylejmani: Faleminderit Kryesues, te nderuar të pranishëm! Drejtoria e Kulturës në vitin 2014, siç e ceket edhe ju, po sa e kemi marr mandatin e kemi konfirmuar fitimin e projektit për rinovimin e shtëpisë së kulturës në kuadër të komisionit evropian, që nënkupton nga fondet e komisionit evropian dhe vlera e këtij projekti ka qenë 167 mijë e 637.18 euro, edhe ne si drejtori e komunës në bashkëpunim me arkitektet, ingjineret komunal dhe kryetari e komunës, kemi konsideruar se kjo vlerë është e pa mjaftueshme për te bërë rehabilitimit e tërësishëm të shtëpisë së kulturës, prandaj ne si drejtori se bashku me kryetarin e komunës, kemi zhvilluar disa takime, konkretisht me z.Kristof Shtok në komisionin evropian dhe me zyrtar të tjerë të çështjes përkatëse në komisionin evropian, dhe ne kemi insistuar vazhdimet që vlera e këtij projekti të rritet në mënyrë që të bëjmë, pra, zgjidhjen permanente të problematikave që janë në shtëpinë e kulturës. Pra, komisioni evropian e ka arsyetuar kërkesën tone dhe e ka arrit vlerën e projektit, d.m.th. tani ma e kemi te konfirmuar, që vitin e ardhshëm e kemi edhe konfirmimin zyrtar nga z.Krisfto Shtok, që punimet do të fillojnë në vitin e ardhshëm dhe krahas kësaj ne kemi zhvilluar takime edhe me të tjerë si me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ku është lajm i mirë, ku ndoshta nuk kemi bë teri tani lajme publike, d.m.th. edhe MKRS-ja është participantë në këtë projekt me vlerën 309 mijë euro. Pra, që nënkupton një vlerë te tërësishme diku 700 mijë euro, që do te hy në renovimin e shtëpisë së kulturës, ndërsa komisioni evropian do ti zhvillon punimet e veta në kulmin e shtëpisë së kulturës, ndërsa MKRS-ja do të bënë punimet e tjera. Unë dua ta rikonfirmoj, që Ministria në kuadër të këtij projekti veç ka investuar në vlerën 25 mijë euro, ku tashti ma ju e keni pa në shtëpinë e kulturës një projekt, që ne e kemi inauguruat ne shkurt të këtij viti. Dua të ju informoj edhe rrethe palestrës sportive, për të cilën kemi diskutuar shume shpesh edhe ne Kuvend edhe në mes Bordit të Drejtorëve edhe në nivel vertikal e horizontal. Kryetari i komunës para dy dite ka pasur një takime progresiv dhe konkretizues me ministrin e Kulturës dhe tani është konkretizuar kjo çështje, ne si Komunë e Vitisë po presim që ta nënshkruaj memorandumin e bashkëpunimit në mes te dy institucioneve, pra, MKRS-ja dhe Komuna e Vitisë, ku mjetet e këtij projekti do të alukohen në buxhetin e Komunës së Vitisë dhe ne këtë memorandum të bashkëpunimit do të ndahen të drejtat dhe detyrimet rrethe implementimit të këtij projekti, për çka shpresoj se vitin e ardhshëm veç Komuna e Vitisë do ti filloje procedurat e prokurimi dhe kjo çështje definitivisht dhe përfundimisht të finalizohet në vitin e ardhshëm.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për ju të pranishmit! Ne i kemi kthy përgjigje avokatit të popullin, megjithatë të ne në drejtori nuk ka qenë askush nuk ka marr kurrfarë shënime, por ju kanë dhënë në mënyrë tjera, e nuk është problem në te ju japin prapë po a është konform të ligjit

dhe as një cenim as një e drejte të asnjë konkurrenti që ka konkuru për pune nuk e ka, prandaj është çështje krejt atje kërkohet një pikë, është për vendas, nëse është vendas ka një pike me shumë, këta nuk e kemi bë na, ka qenë qashtu nga Ministria e Arsimit, a ne Gjilan nuk të pranojnë hiq të Komunës së Vitisë, as sun merr pjesë në konkurs, e ne nuk e kemi hek ne konkurs këtë pikë që e ceka me lartë. E vetmja qe kjo ka qenë pse një pike është e qitur në flet aty si vendas, ku si vendas e ka një pikë me tepër, e për këtë ka qenë dashur të intervenojnë inspektorat regional e jo avokati popullit. Komisioni që bënë vlerësimin e kandidatëve përbëhet nga dy punëtor të DKA-se, drejtori i shkollës, a për pranimi e drejtorëve të shkollave merr pjese dy anëtar që i cakton kryetari i komunës, përfaqësuesi i Ministrisë se Arsimit, kryetari i këshillit të prindërve të asaj shkolle marrin pjesë në komision për punësimin e drejtorëve.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përshëndetje për te pranishmit! Pyetja që u parashtrua, se a është ndëshkuar operatori për prerjen e pyjeve ne fshatin Terpezë, mendoj që përgjigjen në këtë pyetje është dashtë me ju be Drejtorisë së Bujqësisë, prandaj Drejtoria e Inspeksionit nuk ka dikaster që e mbulon sferën e pylltarisë. Pyetja qe ishte, a lejohet derdhja e kanalizimit ne lumenj, është e vërtet që me ligje ndalohet, por, është një projekt që po vazhdon se punuari dhe unë mendoj që është ka përgatitet edhe një kolektor, i cili do të bën ndarjen e atyre mbeturinave. Ndërsa pyetja që ishte për auto taksistet, është vetëm çështje ditësh mos te them edhe orësh, se ne e kemi pa si të nevojshëm një shenj plotësuese në rrugën njëkahëshe ku po pengohet taksistat që te operojnë lirshëm në mënyrë që mos të pengohen puna e taksistave, kjo shenj do te vendoset shume shpejt.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje për kryesuesin, bordin e drejtorëve, Ju Këshilltar e ju të pranishmit! Fillimisht me lejoni të ju falënderoj në emër të kabinetit të kryetarit për krejt punën e bërë gjatë tërë vitit 2016, konsideroj që ishte një pune e shkëlqyeshme, një vit i suksesshëm. Sa i përket pyetjes se pare, kemi thënë e dhe po e përsëris apët, që kompetent për menaxhimin e pyjeve është Agjensioni Kosovar i Pyjeve, prandaj as nuk kemi shpall ne tender, ata e kane shpall ne aspekt ligjor, plotësisht kanë pas të drejt ata të krijohen ato korridore te cilët i shpëtojnë pyjet ne ras zjarri, por me gjithat nga reagimet që janë bë nga qytetaret e Terezës dhe ne si ekzekutiv e kemi ndalu at çështje, por, nuk kemi pas të drejtë ta dënojmë se në aspekt ligjor u kanë shume drejt. Fshati Shusht a janë nën hartën e Komunës se Vitisë, janë, trotuarin qeveria komunale i shtron me prioritet aty ku është qarkullimi i njerëzve më i madhe, i nxënësve me i madhe edhe ne këtë formë po e bene siç janë be shume e po bëhen shumë, edhe te Shusht do ta bëjmë, ndriçimi publik konsideroj që sot a nesër ka me fillu te Shusht dhe bëhet, ndërsa kërkesa për rrugët qe duhet të jen parimor, ju jeni ata të cilët e keni aprovu buxheti e Kuvendit Komunal, nuk e di a do te hynë qëto rrugë, nuk po tham që nuk e meritojnë, e meritoj, por, duhet t'i shiqojmë cilat rrugë janë me prioritet. Skifteraj ka fituar bukur shume me investime nga kjo qeveri, fal kësaj politike te këtij kryetari, duke filluar nga ndërtimi i ambulancës, mbulesës se shkollës që e kemi renovu tërësisht, e mos te flas përfitime te serave, se është një prej fshatrave që ka fitu me se shumti. Te çështja e avokatit te popullit, e tha drejtori, ku edhe drejtori e ka me

te drejtë po edhe ti që parashtron pyetje e ki me te drejte, se duhet ta dimë ne, kandidatët kanë bërë ankesë për shkeljen e të drejtave të njeriut, jo shkelje të ligjit, ku e kanë bërë në institucioni e avokatit të popullit edhe në këtë drejtim ata kanë than pse qet robrikë e ki shtu një poen e ka me shumë, ne rast që është i Vitisë me shume se ai i Gjilanit, që e kanë konsideru që është shkelje e të drejtës së njeriut e ku edhe në konsideroj që është shkelje. Punëtorët me shërbime të veçanta, asnjë punëtori pas 3+3 nuk ja kemi vazhdu dhe nuk i kemi thënë me nej ne vend të punës, të gjithëve ju kemi thënë ka përfunduar duhesh me shku, janë dy raste te cilët e kanë vazhdu për shkak edhe të programit që nuk kemi muajt me i shti në sistem janë, ndërsa te tjera nuk ka, e çështja e sekretarit të Smirës, ti e din që ka qen kontest gjyqësor dhe është në procedurë, por, e di që janë zbatu ato që janë ardh nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Çështja e planit të mobilitetit, ai nuk është plan që mundet të kryhet për një ditë, unë besoj që është ne vazhden e kryerjes çdo vit nga pak, besoj që kemi me e realizu.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë e di nënkryetar që je ne ngjarje të zhvillimeve në komune, e di që përgjegjës për menaxhimin e pyjeve është Agjensioni Kosovar i Pyjeve, por, megjithatë ne shpi tanë kerkush nuk vjen pa trokit pa i tregu dikujna, atëherë ma merr mendja që u desht me trokit ne deren e juaj ose ne deren e Drejtorisë se Bujqësisë. Sa i përket fshatit Skifteraj gjithmonë ka me ngrit çështje jo vetëm për Skifteraj, por, për krejt, e ku e dimë që ne aspektin patriotik Skefteraj ka dhënë mjaftë, kush ka dhënë dëshmor me shumë se fshati Skifteraj, ne aspektin ekonomik 46% i përgjigjen tatimit në pronë. Nëse motoja e drejtorit te Ekonomisë ka qenë që mu rrit mbledhja e tatimi në pronë e të ju kthehet ne formë të investimeve kapitale, atëherë çka me ju dhënë qytetarëve, çka me ju dhënë motivim nëse e paguni tatimi ne pronë ka me ju kthy ne formë të investimeve kapitale. Se të jeni të bindur se me shume se 60 nxënësia kaloj ne ato rrugë dhe janë kogjo të rrezikshëm. Sa i përket per fshatit Shushtë, nuk po du me i përmend edhe premtimet që i ka dhënë kryetari, se kogjo shumë premtime ka dhënë, por, këto që i pyeta unë janë esenciale.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Premtimet të cilat i ka dhen kryetari po i matin organizatat e ndryshëm dhe po e qesin njësh në nivel të Kosovës, e unë duhet ti besoj dikuj, ky nuk është mendim i imi, as i drejtorëve, por, është mendim i atyre që e kanë përcjell se çka ka premtu dhe ata jane e ku ne mesin e tyre edhe Shpend Ahmeti po ja liron vendin po i thot hec se ti je njishi prandaj është mirë të sillem konform asaj, e diçka kem premtu te Shushtë, por ende kemi mandat edhe këto premtime kemi me i realizu e me i tejkalu, 14 milion e 400 mije janë kanë investime të kryetarit për katër vjet, mos harro se e ka kaluar shifrën 20 mijë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Për seancën e rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
2. **Propozim ndryshimi i rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**
3. **Propozim rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.**
4. **Propozim plani i mirëmbajtjes të Hapësirave të Hapura Publike në Komune e Vitisë 2017-2021.**
5. **Propozim Plani i investimeve në hapësirat e Hapura Publike.**
6. **Propozim vendim për caktimi e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit e të Komunës së Vitisë.**
7. **Daft Plani i punës për vitin 2017, i KKS-së.**
8. **Propozim vendim për pezullimi e përkohshëm të nenit 21 dhe nenit 13 pika 13.6 dhe neni 41 të Rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka, unë po e qes ne votim për miratim: Kush është që të miratohet ky rend i ditës me këto pika?

Nga të gjithë të pranishmit u miratuar rendi i ditës

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjeta e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, po e qes në votim për miratim: Kush është që miratohet pika e parë e rendit të ditës: Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua pika e parë e rendit të ditës.

z.Samet Indriz: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Unë kam vërejtje te procesverbali, se është i cunguar bukur shumë, ndoshta në mungesë të televizionit, por sa vetëm ky procesverbal por edhe dy procesverbalet e me hershem nuk kanë qenë mirë, duhet procesverbali me qen me unik se ka gabime edhe drejtshkrimore e gabime te tjera. Unë e pash ku kam debatu, ku gati 50% e fjalimit mungon.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka te tjerë për diskutim, po e qes në votim për miratim: Kush është që miratohet pika e parë e rendit të ditës? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Pika e dytë

2. Propozim ndryshimi i rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Si zakonisht gjatë përgatitjes së buxheteve komunale përcjellët edhe dy rregulloret që kanë të bëjnë me strukturën e menaxhimit te buxheteve komunale, është fjala për të hyrat vetanake, pra, kësaj radhe është edhe rregullorja për propozim ndryshimi e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, që zakonisht miratohet ne Kuvendet Komunale. Në vitin paraprak për vitin vijues, kjo rregullore është përpiluar në baze te gjitha ligjeve pozitive që janë ne dispozicion për aplikim gjate aplikimit të kësaj rregullore. I kemi bërë te gjitha përgatitjet, është një rregullore që përfshin te gjitha të hyrat komunale për aktivitetet dhe shërbimet e tyre që i kryen për qytetaret e komunës dhe këtu janë të përfshirë pjesa dërmuese e drejtorive përkatëse që kanë të hyra dhe inkasojnë të hyra

për buxhetin e Komunës së Vitisë. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet dhe sugjerime jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Vjollca Kadolli Halili: Përshëndetje për ju te gjithë te pranishmit! E dimë që rregullorja ka qenë ne dëgjim publike, megjithatë ne seancën e kaluar unë kame pas disa vërejtje me shumë në terminologji e që nuk janë inkorporua, prandaj vetëm po i përsëris ato që i kam dhënë ne seancën e kaluar. Te neni 9, Drejtoria për Arsim thotë: “lirohen nga pagesat nenat e veja që janë në marrëdhënie pune”; edhe atë ditë kam kërkuar që duhet te ndryshohet timologjia dhe duhet të jenë fëmijët e nenave vet ushqyese dhe duhet te inkorporohet kjo. Te neni 9.5 prapë, te Drejtoria e Arsimit, ku thotë: që nga taksat lirohen personat me aftësi të veçanta”, kështu që duhet te jetë me nevoja të veçanta sipas ligjit, mendoj që këto dy terminologji duhet të ndërrohet e nuk kam vërejtje tjera.

z.Nuredin Lutfiu: Ne seancën e kaluar kame propozuar që nga pagesa për shërbime komunale të lirohet të gjithë personat mbi moshën 65 vjeçare dhe kërkojnë që ky propozim i imi të inkorporohet në rregullore nenit 6 pika a.

z.Samet Idrizi: Te Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, neni 11, pika 1, bazuar në udhëzimin administrativ nr. 41/2006 për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore, propozohen këto taksa. Unë kame një propozim, që te klasa e parë deri te klasa e katër, ku është 1 euro për metër katror, nëse na i mundëson ligji me e rrit pak këtë tarifë tu e pa degradimi dhe zënien e tokës bujqësore në mënyrë kaq te egër, jo vetëm në Viti po ku do ne Kosovë. Është mirë që këtë me e bë 1.20 ose 1.50.

z.Bekim Azizi: Mendoj që te neni 9, te Drejtoria e Arsimit neni 9.4, kur kemi ku ka hi tashti edhe mësim për të rritur, mësimi joformal, mendoj që këtu duhet të bëhet edhe një nen i veçantë që parasheh atë që munde të lirohen nga këto pagesa për mësimin për të rritur, sepse zakonisht problemet kryesore nëpër shkolla janë me lirim e këtyre kandidatëve që lirohen për mësimin për të rritur. Mendoj që duhet te plotësohet se cilat kategori lirohen nga pagesa te mësimi për të rritur.

znj. Mirlinda Sadiku: Te Drejtoria e Administratës, neni 6, i kemi kategoritë të cilat lirohen nga pagesat, është viktimat e luftës a është familjar i viktimave te luftës, po ashtu të njëjtën mendim e ndaj me znj.Vjollca që e ceku me parë. Te Drejtoria për Arsim, te neni 9.3.1, po me intereson ta di a është e përcaktume me ligje, p.sh.: për një dublikatë të dëftesës së shkollës së mesme 1 euro apo është e përcaktuar me rregullore. Për mendimi tem është shumë pak 1 euro. Në mungesë të rregullores për mësim joformal, këtu nuk e kemi të inkuadruar, ne do të fillojmë ne Janar me mësimin joformal. Ne nuk e dimë, kemi me hap konkurs e nuk e dimë cilat kategori te njerëzve kanë me tu liru prej pagesave nëse ju mundësohet. Te Drejtoria e Gjeodezisë dhe Katastrit, te neni 10.17, me intereson ta di objektet fetare nuk janë te liruara nga pagesa për një metër katror, ata shpenzohet 0.30 cent. Nga drejtori i Financave dua ta di, nëse ka mundësi që bizneset që udhëhiqen nga femrat te iniciohet pse jo edhe nga grupi i grave, që te behet një zbritje për taksen e tyre komunale, d.m.th. bizneset që udhëhiqen nga femrat e që janë aktive.

z.Sami Demelezi: Përshëndetje për ju te nderuar te pranishëm! Te faqja nr. 10, Drejtoria e Bujqësisë, neni 11.2, çertifikata për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe çertifikat që merret me veprimtari bujqësore, nuk e di a aplikon najkush me marr këtë qertifikatë a po vetëm figuron këtu, pastaj te neni 12.1.3 shfrytëzimi i hapësirave publike për ekspozimit e prodhimeve pran lokaleve, neni 13.2.8, 13.2.9, 13.2.10 e kështu me radhe sepse në një rën nga trajtimet që kemi

pas na u është thënë nga trajnerët se këtu që parashihet ne qet rregullore janë ligje, prandaj duhet të kemi kujdes, se në rast se naj auditim i mundshëm, pastaj do te jetë keq për drejtorët. Edhe vitin e kaluar kur kemi debatuar për këtë rregullore, te neni 16, komuna ngarkon me taksa, subjektet afariste dhe personat fizik te cilët janë pronar të automjeteve, na pa e paguar qet taksen 10 euro nuk mundesh ta regjistron automjetin, prandaj pse figuron kjo. Te urbanizmi, te sektori i ambientit, po gjoba ambientale nuk pash kerkun, mirë ka qenë me u parapa, sepse kur po i kemi pasqyrat financiare këto po na figurojnë me zero zero.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje për te gjithë! Unë e lexova materialin, mirëpo problemi është se apo mundemi me i mbledh ato taksa, p.sh.: dikun e lexova, që me hy një kamjan mbipeshë ne Viti, për mu ndal një ore duhet me pagu tri euro, apo nuk po e di sa, por, po thamë unë, kurrë nuk kam pa që dikush pa paguar në qete farë forme. Është mirë që po regjistrohet ato, ama janë do sene që na nuk mujmi asnjëherë me i shfrytëzu. Te kategorizimi i taksave, është mirë me muj me bë pak me reale, sepse i shof do biznese aty, me te vërtet janë gati ne përfundim, në vdekje, p.sh.: fotografisti shume pak ka punë, e ngarkojmë me 70 euro apo sa ke nuk po e di. Na duhet ta kemi njëfarë liste përafërsish në bazë të asaj te hyrje – dalje, se sa kah pas ajo firmë, nëse ka pash p.sh.: 1 milion euro me i qit pak me shumë, nëse i ka pas 200 mije euro pak me pak. Këtë far forme me muajt me gjetë.

Drejtoresha znj.Kaltrina Sylejmani: Edhe në debatin publik me 15 dhjetor kemi dal me tri propozime konkrete si Drejtori e Kultures. Kështu që po propozoj që të shtohen tri taksa, pra për shfrytëzimin e galerisë së arteve, të shtohet vlera 50 euro, për qendrën rinore 40 euro, dhe për kinemanë 70 euro. Mendoj që janë taksa shume të arsyeshme dhe sigurisht shfrytëzimi i tyre institucioneve nga organizatat profitbile do te kontribuonin pra të hyrave vetanake.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Na si drejtori kemi disa propozim ndryshime ne këtë rregullore. Duke pasur parasysh se ne seancën e kaluar e aprovuam Rregulloren për Shërbimet e Merimangës, andaj duhet këtij t'i kuorporojmë edhe në rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba, d.m.th duhet ta bëjmë plotësimi e nenit 14 të kësaj rregullore si dhe të nenit 13. Këtu e kemi plotësim vetëm një pikë, pra, po filloj nga neni 13, pika 1.5 për automjetet që shfrytëzojnë hapësirat përkatëse, për auto parking te rezervuar publik, ku i kemi paraparë personat juridik që paguajnë 25 euro ne muaj dhe personat fizik 15 euro ne muaj, ta shtojmë edhe një pike, piken c, për automjetin e kryqit te kuq, ta lirojmë prej pagesës, ku edhe e kemi pas kërkesë e ku edhe ne komunat tjera automjetet e kryqit te kuq për shkak të veprimtarisë se tyre humane dhe vullnetare që bëjnë, t'i lirojmë nga kjo taksë. Te neni 14 i kësaj rregullore, taksat komunale për bartjen e automjeteve nga trafiku, shërbimi i transportit me merimangë, neni 14 pika 1, zhvendosja e motoçikletës, veturës dhe traktorit pa rimorkio brenda qytetit deri në vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri ne 24 orë duhet paguaj taks 30 euro, Neni 14, pika 2, tërheqja e autobusit, mjetit transportues rimorkios ose gjysmë rimorkios brenda qytetit deri në vendit ku u vendoset për ruajtje deri ne 24 ore paguan 100 euro. Neni 14, pika 3, zhvendosja e automjeteve nga zonat jashtë qytetit, pa ngarkesë është 0.25 euro për një kilometër, ndërsa me ngarkesë 0.50 euro ne kilometër. Neni 14 pika 4, ne raste kur zhvendosja e automjeteve vetëm fillon, por, nuk behet zhvendosja deri ne vendin e ruajtje zbatohet çmimi si vijon, në zonën urbane 15 euro, ndërsa jashtë zonës urbane 30 euro. Neni 14, pika 5, kur automjeti i zhvendosur pas kalimit të kohës prej 24 orësh nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi siç përcaktohet në këtë rregullore për çdo dit të ruajtjes apo qëndrimit të mëtutjeshëm të automjeteve, paguhet çmimi prej 5 euro për çdo ditë. Neni 14, pika 6 për ç'bllokimin e

automjeteve, autobusëve, mjeteve transportuese, mjeteve të punës dhe rimorkios, duhet paguar çmimin prej 15 euro. Neni 14, pika 7, nëse për automjetin e bllokuar pas kalimit të kohës prej 24 orë pronari ose shfrytëzuesi i automjetit nuk i përbush detyrimet si që i përcakton kjo rregullore për ç'bllokimin e automjetit, ruajtja përkohësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit nën bllokim për çdo ditë qëndrimi dhe ruajtje do të paguhet çmimi prej 5 euro. Këto janë propozimet e tona, i bazuar në rregulloren që është miratuar para disa dite. Këto janë taksa në nivel vendi.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Te gjitha propozimet për ndryshime të kësaj rregullore do ti kemi parasysh me një kusht që ato të jeni konform ligjit të gjitha kërkesat e juaja apo propozimet që kanë bazë ligjore ne do ti inkorporojmë në këtë rregullore, tu mos i përjashtu edhe propozimet e drejtorive përkatëse, e besoj që do të del një rregullore e mirë për inkasim të të hyrave vetanake.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Te automjete që shfrytëzojnë hapësirat përkatëse të parkingut të rezervuar publik, thotë për persona fizik 15 euro në muaj, këtu nënkuptohet që janë edhe ata të cilët janë banor, e ku unë mendoje se është një shumë e madhe prej 15 euro në muaj për shkak se personat që banojnë aty i kanë banesat afër, prandaj unë propozoj që të ulet kjo shumë. Propozimi im është shumë më i logjikshëm të jete 8 euro.

znj. Mirlinda Sadiku: Propozimi që erdhe nga drejtoresha për Kulturë, që tha për Kinema është 70 euro e për Galeri 50 euro: A është kjo standard për krejt Kosovën apo drejtoria juve e ka përcaktuar këtë shumë, që do të merret prej atyre që e shfrytëzojnë si dhe a do të kihet parasysh nëse kemi ndonjë rast, naj talent që në mesin e nxënësve ka shumë talenta që donë me hap një ekspozitë, a duhet të kihet parasysh që ata nuk kanë pare, nuk gjenerojnë të ardhura, a do të kihet parasysh këto raste?

Drejtoresha znj. Kaltrina Sylejmani: Taksat komunale vlejné për organizatat profitabile që të ritë talentet, rinia shkollore, vullnetaret organizatat joqeveritare komunale janë organizata jo profitabile, përveç nëse kanë naj projekt nga Ministria apo institucioni relevant, atëherë edhe taksohen, përndryshe shfrytëzimi i tyre hapësirave për ta është falas, të Kinemaja ne nuk jemi bazuar kerkun për shkak se vetëm ne si Viti e kemi një kinema publike, nuk ka kinema publike ne Kosove tjetër përveç kinemas ABC, e cila rregullohet ndryshe, e cili është institucion privat, por ne tu i pas parasysh hargjimet dhe aparaturën e kinemasë, që është jashtëzakonisht e shtrenjtë, ne propozojmë që do të ishte e mirë që nga një autor apo regjisor apo organizatë profitabile që e shfrytëzon kinemanë që të taksojmë, pra, me 70 euro, ndërsa për galerinë e arteve e di që edhe disa komuna të tjera e kanë po këtë taksë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Fermerët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre, si në pylltari edhe në veprimtari tjera, pajisen me certifikatë jo gjithherë, por, pajisen me tepër kur atyre ju nevojitet për aplikime për viza nëpër ambasada dhe e shfrytëzojnë atë dhe ka raste të cilët janë pajisë.

Drejtori z.Isak Sadiku: Përshëndetje për të pranishmit! U kërkuar që të lirohen nga pagesa personat mbi moshën 65 vjeçare, dhe tjetra për viktimat e luftës. Te viktimat e luftës ka të bëjë edhe për familjet e tyre, kurse sa i përket për me i liru personat e moshës mbi 65 vjeçare, këtu ju munde të vendosni.

Kryesuesi z.Naim Pira: U dhanë disa propozime nga ana e asamblistëve dhe nga drejtorët, një ishte nga Drejtoria e Kulturës, për ngritjen e taksave. Drejtori i Shërbimeve Publike, me e harmonizua rregulloren rreth merimangës, gjithashtu nga asamblistët ishin disa rekomandime. Unë të gjitha qeto propozime të cilët u dhanë nga ju me i qit në votim: A jeni që këto propozime të inkorporohen në rregullore, kush është që këto të inkorporohen në rregullore? Nga të gjithë të pranishmit u votuan këto propozime që të inkorporohen në rregullore, e unë në funde duhet

ta qes në votim rregulloren në përgjithësi me këto propozimet të cilat u dhanë, ju lutem me ngritje dore, konstatoj që nga të gjithë të pranishmit u miratua rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

Si pike të tret kemi:

3. Propozim rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Kjo është një rregullore e cila ju ka nënshtruar të gjitha procedurave, është punuar se bashku me DEMOS-in që një kohe të gjate, çka që po i falënderoj për kontributin e dhënë, kjo rregullore është diskutua edhe me drejtorët që janë, të cilët janë të implikuar në këtë rregullore të subvencioneve, prandaj unë po ja jap fjalën nënkryetarit rreth kësaj rregullore.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Kryesuesi i e elaboroj në pika të shkurta rreth ecurisë së rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, që kjo ka qenë projekt i DEMOS-it se bashku me asociacionin e komunave kanë kontribuar edhe kryesuesit e kuvendeve, kanë qenë edhe drejtorat, të gjithë ata drejtorë të cilët preken me këtë rregullore. Pas marrjes së draftit, të cilin e kemi marr, që ju ka shpërnda të gjitha komunave, kryetari i komunës ka formuar një grup punues, që koordinatori i grupit punues kam qenë unë dhe kemi punu këtë rregullore të cilën e keni para jush. Kemi pas rregullore edhe me parë, po kanë qenë të veçanta, tash e kemi rregulloren e kompletuar dhe besoj se ajo që është me rendësi, kemi bërë përpjekje që ndarja e subvencioneve, të rritet transparenca, gjithçka të bëhet përmes komisioneve, të kenë të drejtë si monitor të saj të jen edhe shoqëria civile. Krejt e kemi, që të rritet çështja e transparencës në ndarje e subvencioneve, propozim rregulloren e keni pranuar me kohë, për pyetje, sugjerime jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës, kush do ta merr fjalën.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për te pranishmit, kjo rregullore që e kemi para veti i ka në mënyrë specifike të specifikuar të gjitha obligimet dhe të drejtat për ata që aplikojnë për subvencione. Në kuadër të kësaj rregullore i kemi me vendim të kryetarit, që propozohet edhe komisioni për verifikimin e aplikanteve që aplikojnë për subvencione, por, njëherë kemi edhe komisionin për ankesa në raste të parashtrimit të ankesave për personat që refuzohen ose nuk ju ndahen subvencionet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë po e qes në votim për miratim: Kush është që të votohet kjo rregullore? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

4. Propozim plani i mirëmbajtjes të Hapësirave të Hapura Publike në Komune e Vitisë 2017-2021.

Propozim Planit i investimeve në hapësirat e Hapura Publike.

Edhe ky plan ka kaluar përmes debatit publike, fjalën ja kaloj drejtorit

Drejtori z.Ajet Sallahu: Përshëndetje për ju të pranishëm! Në përputhje me dispozitat ligjore dhe me propozimin e kryetarit të komunës, kryetari i komunës ka themeluar grupin koordinues dhe grupin punues për hartimin e këtij plani të mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në Komune e Vitisë 2017-2021 dhe Planit i investimeve në hapësirat e Hapura Publike, fushë veprimin e planit të mirëmbajtjes. E keni pasur materialin me kohë, nuk do të flas me shumë për këtë, mirëpo do të ju njoftoj që shpallja e shqyrtimit publik është bërë në tri gazetatat të përditshme dhe

në mjetet e tjera publike të informimit. Shqyrtimi publik është organizuar dhe është mbajtur, të gjitha sugjerimet që janë dhënë i kemi marrur i kemi analizuar dhe inkorporuar në planin tonë, prandaj nga ju kërkoj që ta votoni, në mënyre që te aprovohet një dokument shumë i rëndësishëm për komunën tonë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pike: A e do fjalën dikush?

znj.Hyse Rama: Përshëndetje për te gjithë! Unë e kame një kërkesë për këtë pikë të rendit të ditës. Propozim plani i mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në Komune e Vitisë 2017-2021, te pika 1.3, fushëveprimi i planit të mirëmbajtjes së Hapësirave të hapura publike faqe 7,8,9 i këtij plani, arsyetim. Njoftoj kryesuesin dhe këshillin komunal, se në fshatin Ballancë kemi një lapidar të ndërtuar në Gusht të vitit 2011, për dëshmorin Muharrem Kurteshi, i lindur me 1905 dhe i vrarë me 04.01.1945, nga forcat Serbosllave të Luftës së Dytë Botërore. Unë si këshilltare që vij nga ky fshat, propozoj që edhe ky lapidar të përfshihet në Planin e mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në Komunë të Vitisë 2017-2021, se e pash që nuk është përfshi, nuk e di a e keni bënë ndonjë lëshime, konsideroj që ky plane i mirëmbajtjes dhe investimeve për periudhën afatmesme duhet të ketë në listën e përkujdesjes paralel me listën e Hapësirave të Hapura Publike, që është në faqe 8. Ju njoftoj që për këtë lapidar dhe rënien e dëshmorit Muharrem Kurteshi është nxjerr një libër si monografi për Ballancen dhe Muharrem Kurteshi është një familje e cila ka sakrifiku shumë në aspektin kombëtar. Unë kame dëshirë, që ky propozim të futet ne këtë plan.

znj. Ajtene Frangu: Përshëndetje! Në këtë plan te mirëmbajtjes, unë mendoj që duhet të parashihet për mirëmbajtje edhe pllaka përkujtimore e Sherif Frangut, në rast dëmtimi, pasi që në këtë listë nuk figuron mirëmbajtja e kësaj pllake.

znj. Mirilinda Sadiku: Po me intereson ne kuadër të atij grupi punues, siç jemi ne dijeni ne si Kuvend e kemi miratu një strategji për persona me aftësi të kufizuar: A është marr parasysht ndonjë ide e atij grupi të marginalizuar, për arsye se kemi shume institucione publike, ku fatkeqësisht këta njerëz nuk mund të kenë qasje? Tjetra, p.sh.: e keni operatorët kreativ, sapo na tha drejtoresha, që vitin e ardhshëm planifikohet ndërtimi i palestrës edhe a do të përkujdeseni edhe për ato hapësira, a do të jetë në domenin e këtij plani?

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për ju të pranishmit! Këtu ne faqe 8 nr. 35 parku ne Verban 10 mije metra katror: A është, apo planifikohet me u bë?

z.Bislim Bislimi: Dua fillimit t'i falënderoj për një vetëdijesim që kane bënë qytetaret e Vitisë për me ngrit lapidar, përmendore, për me i mirëmbajt varrezat e dëshmoreve dhe punën që është bënë nga qytetaret deri me tash është që naj kane lakmi shume komunitat e tjera. Unë gjate leximit të materialit e pash, që për varrezat te fshatrave nuk kemi mundësi, e kuptova, por, në të ardhmen do te futen edhe ato varreza, do të behet shume mirë. Te varrezat e dëshmorëve të vitin 1912 në Lubishtë, unë kam mendu që ka rrugë edhe prej Lubishtes me ra aty, kur kemi shku te varrezat, aty prrocka e kishte shkatërru pronën, ato gypat ishin mbyll dhe uji kishte depërtu në tjetrën anë, mezi që kemi dal, gjithë ai lapidar që është bënë, gjithë ai mund, mos ta lamë pa përkujdesje, duhet me i kushtu rëndësi, se ajo është pjesë e historisë sonë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ju falënderoj! Me të vërtet kenë dy a tri propozime, që konsideroj që drejtori duhet me i shënu, e çështja e Ballances që u ngri, që duhet ta zen vendin e vet, lapidari i Sherif Frangut duhet ta zë vendin e vet dhe te tjerat duhet të merren parasysht. Ju faleminderit për kontributin e dhënë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Me qeto sugjerime dhe vërejtjet e dhëna, unë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim vendim për caktimi e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit e të Komunës së Vitisë

Sikur vitet e mëparshme edhe kësaj here ju kemi sjell para juve propozim vendimi për orarin e mbajtjes së seancave të Kuvendit Komunal. Besoj që e keni lexuar materialin: A ka diçka rreth kësaj pike? Pasi që nuk ka për diskutim e qese në votim. Nga të gjithë të pranishmit miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të gjashtë të rendit të ditës e kemi:

6. Draft Plani i punës për vitin 2017, i KKSBB-së

Fjalën ja kaloj nënkryetarit z.Hasan Aliu.

Nënkryetarit z.Hasan Aliu: Në kuadër të udhëzimit administrativ që është i formuar edhe KKSBB, prandaj na jemi obligativ që ta paraqesim planin çdo vit dhe një ashtu edhe raportin e punës të KKSBB-së. Në kemi formuar një grup punues prej tre anëtarëve nga të cilët ka pasur edhe nga përbërja e shërbyesve civil edhe nga Policia e Kosovës njësi në viti, e kemi përpiluar dhe ju kemi paraqitur para juve, e ku besoj që e keni pranuar me kohë, për sugjerimet që mund të dalin nga ju mund të inkorporojmë në këtë plan.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pike: A do dikush fjalën? Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim këtë pikë të rendit të ditës: Kush është që të miratohet? Konstatohet që nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për pezullimi e përkohshëm të nenit 21 dhe nenit 13 pika 13.6 dhe neni 41 të Rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba

Fjalën ja kaloj drejtorit.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje! Gjithnjë duke u bazuar në neni 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në Statutin e Komunës, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë Propozim vendim për pezullimi e përkohshëm të nenit 21 dhe nenit 13 pika 13.6 dhe neni 41 të Rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vitisë kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që ta aprovon vendimin për pezullim të ngarkesës së taksës komunale për të gjitha subjektet afariste të Komunës së Vitisë të parapara me neni 21. Pika 13 dhe pika 13.6 dhe neni 41 të Rregullores Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba, duke filluar nga 01.01.2017 deri me 31.12.2017, ky është një vazhdimësi, ky është viti i gjashtë që kryetari i komunës i pezullon këtë takse për të mirën e biznesit në territorin e Komunës së Vitisë. Kjo është esenca e këtij propozim vendimi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pike: A ka dikush për me diskutu.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për të gjithë juve prezent! Unë edhe herën e parë kur është bisedu, kam pas një mendim ndryshe rreth kësaj çështje të trajtimit. Drejtori tha që është viti i pestë që këto biznese ju falet kjo taksë, unë po them që ky është viti pestë që na me këto biznese

nuk jemi marr fare, as me obligimet që kanë met, me atë që janë grumbulluar me vite as me eventualisht identifikimin e tyre bizneseve aktive, bizneset që do të paguaj në mënyrë që ta qesim në binar këtë çështje. Unë mendoj ndryshe, tu e pas parasysh se që nja pesë vite nuk jemi marr me këtë çështje, unë mendoj që propozimi për me i liru ose me e pezullu këtë ngarkesë duhet të jete që t'i ngarkojmë se paku 50% nga kjo takse, në mënyrë që gjatë këtij viti që po hymë te merrmi me këtë çështje, mos ta lëmi në harrës siç e kemi lenë që pese vjet. Dihet që ato ngarkesa kanë qenë ndoshta problematike për brenda atyre, nuk kanë qenë precize adresat e tyre, evidenca, nuk është përcjell gjendja fare a janë aktiv a jo, a janë shumë a jo. Regjistri i bizneseve ka qenë jo i sekt edhe me mundësi lë lehta te manipulimeve. Shlyrja nga evidenca ka qen në dorën e individëve edhe varësisht prej disponimit tina, ka mujt që njerëzit të lëshyhen nga evidenca apo të mbesin në evidencë, kështu që mendoj që obligim i drejtorisë për vitin që po vjen, tu e pas parasysh ngarkesën për 50%, se pa këtë ngarkesë po konsideroj që kishte me vazhdu ky avanc, obligim i drejtorisë apo një ekip të caktuar, do të ishte që të merret seriozisht me këtë çështje të bëhet një databazë e sigurt, që mos të ketë mundësi të ndërhyrjes kushdo edhe të hetohen ato ndërhyrjet nëse bëhen edhe ngarkesat të jen reale konform gjendje reale që është në teren, ky regjistër e kame fjalën. Propozim im është që këto ngarkesa të mos pezullohen, tu e pas parasysh këtë arsyeshmëri, sepse pezullimi po na prolongon ose po na shtynë marrjen me këtë çështje.

znj. Mirlinda Sadiku: Këtu në këtë foltore, shpeshherë e kame cekë pikërisht edhe vitin e kaluar kur na ka ardhur kjo, kam thanë që nuk mundem me shku deri në pafundësi, dikun duhet ti vendoset një pikë, ku prej atij momenti duhet me fillu me kontribu për shtetin, e drejtori shumë mirë e potencoj. z.Dauti e di që Kosova është tu vuajt edhe prej evazionit fiskal po ashtu edhe prej ekonomisë informale, ku një ditë me rastisi që Ministri Avdullah Hoti e pranoj që diku rreth 38% të ekonomive janë informale, prandaj, ne si komune çka mundemi me vepru, është mirë që Vitia tash i ka emërtimet e rrugëve, edhe pse janë shumë ankesa për rrugë, por, ndoshta do të rregullohet. Sa i përket numrave, prapë Deqani është përpara kryesues, Vitia nuk është ende kerkund, po ti kishim adresat, emrat e rrugëve, ndoshta bëhen edhe numrat, e ta dimë sakt se ku janë këto biznese, sa realizojnë, të regjistrohen, të behet lista, të krijohet databaza, të rividohen të ndryshohen të kompletohen çdo vit, po ashtu mos të kenë qasje individ, persona të caktum, që për hatër të një biznesi t'i shlyhet ai borxh kujna kur ti mëteket, sepse na e dimë që Komuna e Vitisë pas veti po ngarkohet që duhet t'i realizoj të hyra komunale, e si ti realizoj këto të hyra komunale nëse ekonomia e një vendi kryesisht është e bazuar në ekonomin private, d.m.th. në bizneset private, prandaj, uroj edhe unë që kjo do të jetë e fundit e te filloj nga dikun.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ky propozim vendim është për herën e gjashtë, d.m.th. që pesë vite ka qenë i pezulluar, tash është për vitin 2017, se seancën e kaluar i kemi falur të gjitha borxhet që kane qenë të evidentuara deri në vitin 2011. Kemi qenë të njoftuar që ka qenë një databazë e dobët. Siç u cek edhe nga këshilltarët, sistemi mbrojtës ka qenë i vogël, ka pas defekte në kuptimin edhe të regjistrimit edhe të pagesës, në këtë sistem të inkasimit të taksës në biznes, për këtë arsye edhe me miratimin e juaj i kemi fal këto borxhe, gjithnjë duke u bazuar ne dibiozat që kanë qenë të përfshira në këtë borxh prej 314 mije euro. Edhe unë pajtohem plotësisht që komuna duhet të mendoj për inkasim të hyrave më të mëdha vetanake, por në disa komuna të Kosovës kjo për hir të dhënies shancë, krahas zhvillimit të ekonomisë, është propozu të pezullohen. Është një taks që nuk ndikon ne përqindje shume të madhe në plotësimin e buxheteve komunale, për këtë arsye është mëndu pezullimi i kësaj takse. Po du me potencu, që gjatë këtij viti kemi

punu, e kemi bë një komision që e kemi përgatit një raport për te ardhëm, që shumë shpejt do të dal para juve për miratim nga ju, për një strukturë të re të inkasimit të kësaj takse nga disa biznese, që kane me një mënyrë super profit apo profit me të lehtë dhe që operojnë në territorin e Komunës së Vitisë. Ne do të mundohemi që në vitin e ardhshëm ta bëjmë një raport të cilin e kemi gati, e për të cilin ju do te vendosni se për cilat ndërmarrje publike apo shërbyese do te jene baze e inkasimit të kësaj takse dhe për madhësinë normale të vlerës për këtë takse. Në këtë drejtim jem tu e përgatit një bazë të shënosh ligjore dhe shume shpejt do të jetë para juve.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka te tjerë për diskutim, e qes në votim këtë propozim vendim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Me tri vota kundër dhe te gjitha të tjerat po, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancat e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11 e 40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
